



**BASHKIA KRUIJË
KESHILLI I BASHKISË**

VENDIM

Nr 57 Datë 11/10/2016

“Mbi shpronësimin për interes publik të pasurive pronë private që preken nga zbatimi i projekt investimit “Sistemim asfaltim i rruges Allamani-Fushë Krujë”

Këshilli i Bashkisë Krujë në mbledhjen e tij të datës 11/10/2016, mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 për “Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” VKM, nr. 127, datë 23.3.2000 për “Përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” VKM, nr. 138, datë 23.3.2000 për “Kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” si dhe relacionit të pregatitur nga Bashkia Krujë:

VENDOSI:

1. Të miratojë shpronësimin për interes publik të pasurive prone private që preken nga zbatimi i projekt investimit “Sistemim asfaltim i rruges Allamani –Fushë-Krujë” sipas listes si vijon:

Nr	Emri Atesia Mbiemri I Pronarit/Bashkepronarit	Nr/Pasurise	Lloji I Pasurise/Sip	Zona Kadastrale	Sip që shpronësohet
1	Irbana Fatbardh Ziri	1/398	Siperfaqe truall prej 400 m2	1664	328.53 m2 (siperfaqe truall)

Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit të Territorit, dhe Drejtoria Juridike.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Kryetari i Keshillit të Bashkisë

